UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+ në Anhalt University of Applied Scienties, Gjermani

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, në Anhalt University of Applied Scienties, Gjermani**.**

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve për studime

Nivelet e mobilitetit për studentët:

Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi në Universitetin Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit**. Studentë duhet të jenë të nivelit Master viti i parë. (Studentët e vitit të tretë/katërt arkitekturë mund të zgjedhin vetëm lëndë të nivelit master viti i parë, semestri i parë).

Kohëzagjatja e bursave: Semestri i parë i vitit akademik 2026 – 2027

Fusha e studimit:

- Arkitekturë
  - MAD- Architecture (DIA), M.A. Campus Dessau
  - MLA - Landscape Architecture (M. A.) Campus Bernburg
- Inxhinieri Elektrike
- Inxhinieri Informatike
  - MET - Electrical and Computer Engineering (M. Eng.) Campus Köthen
  - MBE - Biomedical Engineering (M.Sc.) Campus Köthen

Numri total i studentëve: **4**

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli i kërkuar është nga B1 – C2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit. në Anhalt University of Applied Scienties, Gjermani lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.*
Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për t'u njohur me programet e lëndëve, ju lutemi klikoni në link-un:

https://www.hs-anhalt.de/nc/studieren/orientierung/studienangebot.html

Për të marrë një informacion të plotë mbi programin Erasmus në Anhalt University of Applied Scienties, ju lutemi klikoni ne link-un: Studienangebot und Bewerbung | Hochschule Anhalt

Duke u inkurajuar edhe nga politikat sociale të Anhalt University of Applied Scienties, përparësi do të kenë studentët me aftësi të kufizuara dhe studentët me probleme sociale.

Mbështetja financiare:
Bursat do të jenë midis 4.600 EUR dhe 5.900 EUR për secilin student.
Shënime shtesë mbi mbështetjen financiare:

1. Mbështetje individuale (në muaj)

• Tarifa bazë: 900 EUR

• Tarifë e rritur: 1.150 EUR (kjo është e barabartë me 250 EUR shtesë në muaj për studentët me aftësi të kufizuara / sëmundje kronike ose studentë në disavantazh social ose studentë që vijnë nga një familje pa prejardhje akademike familjare).

2. Mbështetje udhëtimi • aeroplan: 309 EUR • kombinim autobusi/treni: 417 EUR (mjet transporti i qëndrueshëm).

Afati për aplikim: Deri më 20 shkurt 2026

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT. Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit, mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al , abeqo@upt.al .